

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	81 vite burg për 4 ish-liderët e UÇK! 25 vite burg për Thaçin e Krasniqin. Vuçiç: Nuk u dënuan për krime kundër njerëzimit. S'kemi arsye të gëzohemi!
ADRESA	https://versus.al/live-updates/vendime-tronditese-nga-haga-gjykata-denon-me-81-vite-burg-4-ish-kre-i46626
BURIMI	versus.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 10:01:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 07:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	83537fe13fdfbe774f7591e165439e76a74cb6b39832c381e9046108831ab1d9
TEKSTI	316172650bae4495072bf64e17ae6bbd0ec37f7edddfb3773d911a2928dbdb6
PAMJA	9a1acbe8935108c10b63e50a243147fc6101e62339e6fb9b886d4f0283c2d8d6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a19445d51d7fd67775c9133fae7edd4c44cb92fb8fdd07fe155c576e42bdef01
E MËPARSHMJA	4ef6b86ed9a226a90b51c092d5f8e7c7b8a5bc6a62f85d9e0ca1594eecdbebc
RRËNJA MERKLE	78d6084bfd6cb1be1efaeb014ade0ef1539709e636c33f39308264a405fee6e2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a19445d51d7fd67775c9133fae7edd4c44cb92fb8fdd07fe155c576e42bdef01>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

81 vite burg për 4 ish-liderët e UÇK! 25 vite burg për Thaçin e Krasniqin. Vuçiç: Nuk u dënuan për krime kundër njerëzimit. S'kemi arsye të gëzohemi!

16 Shtator 2026, 09:40

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[Live Updates](#) / 16 Shtator 2026, 09:40

81 vite burg për 4 ish-liderët e UÇK! 25 vite burg për Thaçin e Krasniqin. Vuçiç: Nuk u dënuan për krime kundër njerëzimit. S'kemi arsye të gëzohemi!

*Gjykata Speciale në Hagë dënoi me 81 vite burg në total 4 liderët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli e Rexhep Selimi. Pavarësisht rrëzimit të akuzës për krime lufte kundër njerëzimit, gjykata pretendoi se ishin vërtetuar akuzat e tjera të prokurorisë për ndalimin e paligjshëm dhe dhunën ndaj qindra personave si dhe vdekjen e mbi 90 personave. *Sipas gjykatës, të dënuarit bashkëpunuan me njëri tjetrin dhe nuk ndërmorën veprime për të ndalur dhunën apo krimet e tjera ndaj personave që kishin ndaluar në 14 komuna të Kosovës dhe 2 rrethve në veri në Shqipërisë. *Dënimet më të rënda ishin për Thaçin e Krasniqin me nga 25 vite burg, ndërsa Veseli u dënua me 18 vite burg dhe Selimi me 13 vite burg. Atyre do t'u llogaritet edhe koha e kaluar në narahuroim. *Në Kosovë e Shqipëri dënimet shkaktoi tronditje të thellë ndërsa ish-krumministri i Kosovës Ramush Haradinai bëri thirrje për hetësi në frikërrave për trazira në këtë vendim. *Në

fjalën e mbajtur para popullit serb, presidenti në ikje Aleksandër Vuçiq nuk shprehu entuziazëm nga vendimi i Hagës pasi sipas tij, krimet kundër popullatës serbe u rrëzuan dhe besueshmëria e UÇK nuk u cenua



Shkruar nga Versus

Çfarë do të gjeni në brendësi

*Gjykata Speciale në Hagë dënoi me 81 vite burg në total 4 liderët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli e Rexhep Selimi. Pavarësisht rrëzimit të akuzës për krime lufte kundër njerëzimit, gjykata pretendoi se ishin vërtetuar akuzat e tjera të prokurorisë për ndalimin e paligjshëm dhe dhunën ndaj qindra personave si dhe vdekjen e mbi 90 personave. *Sipas gjykatës, të dënuarit bashkëpunuan me njëri tjetrin dhe nuk ndërmorën veprime për të ndaluar dhunën apo krimet e tjera ndaj personave që kishin ndaluar në 14 komuna të Kosovës dhe 2 rrethve në veri në Shqipëri. *Dënimet më të rënda ishin për Thaçin e Krasniqin me nga 25 vite burg, ndërsa Veseli u dënua me 18 vite burg dhe Selimi me 13 vite burg. Atyre do t'u llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim. *Në Kosovë e Shqipëri dënimet shkaktoi tronditje të thellë, ndërsa ish-kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj bëri thirrje për qetësi pas frikërave për trazira pas këtij vendimi. *Në fjalën e mbajtur para popullit serb, presidenti në ikje Aleksandër Vuçiq nuk shprehu entuziazëm nga vendimi i Hagës pasi sipas tij, krimet kundër popullatës serbe u rrëzuan dhe besueshmëria e UÇK nuk u cenua

24 Postime
25 MINUTA ME PARE

Apelimi i vendimit të Hagës ndaj 4 ish-krerëve të UÇK-së, avokatët mbrojtës: Procesi mund të marrë vite kohë



Ekipet mbrojtëse të ish-eporëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë paralajmëruar se do të apelojnë aktgjykimin dënues të shqiptuar nga trupi gjyqësor i Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë më 16 shtator.

Hashim Thaçi u dënua me 25 vjet burgim për katër pika të aktakuzës për krime lufte, Jakup Krasniqi po ashtu u dënua me 25 vjet burgim, ndërsa Kadri Veseli me 18 dhe Rexhep Selimi me 13 vjet burgim.

Të katër ish-eporët e UÇK-së u shpallën penalisht përgjegjës për krime lufte që përfshijnë ndalimin e paligjshëm ose arbitrar, trajtimin mizor, torturën dhe vrasjen e paligjshme. Gjatë aktgjyimit të shqiptuar në Hagë, trupi gjyqësor hodhi poshtë akuzat e ZPS-së për krime kundër njerëzimit.

Katërshtja e UÇK-së gjendet në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020.

Vendimi i trupit gjyqësor mund të apelohej nga palët e përfshira, nga mbrojtja e cila mund të kërkojë rrëzimin e aktgjyimit në tërësi apo të synojnë uljen e dënimit për pika të caktuara të akuzës, por edhe Zyra e Prokurorit të Specializuar që mund të kërkojë ashpërsim të dënimit.

ZPS-ja mirëpriti vendimin dënues dhe shtoi se do të shqyrtojë të gjithë aktgjykimin, përfshirë edhe rrëzimin e pikave të akuzës që kishin të bënin me krime kundër njerëzimit.

Por, cilat janë procedurat që palët ndjekin për apelin?

Sipas Rregullores së Procedurës dhe Provave, palët që apelojnë vendimin e gjykatës ose dënimit, ose të dyja së bashku, duhet të dorëzojnë atë që quhet njoftimin për apel, ku parashtrihen arsyet e apelit, 30 ditë nga shpallja e aktgjyimit.

Më pas, kryegjykatësi i panelit të Gjykatës së Apelit - gjykatë që përbëhet nga tre anëtarë - mund të caktojë një prej gjykatësve si gjykatës raportues për procedurën paraapeluese. Gjykatësi raportues ka për detyrë të marrë masat e nevojshme për aspektet procedurale, sikurse janë lëshimi i vendimeve, urdhrave dhe udhëzimeve me qëllim që të përgatitet çështja për shqyrtim. Ai duhet që rregullisht ta informojë panelin e Gjykatës së Apelit, veçmas nëse ka kontestime lidhur me çështjet procedurale.

Më pas, brenda 21 ditësh nga njoftimi për apel, kryegjykatësi apo gjykatësi raportues e thërret një konferencë ku ngrihen çështje rreth apelit.

Palët që parashtrijnë apel duhet të dorëzojnë dosjen e apelit e cila përmban të gjitha argumentet dhe burime të tjera ligjore ku mbështeten arsyet e apelit. Kjo duhet të dorëzohet brenda 60 ditësh apo brenda 30 ditësh nga njoftimi për apel, nëse çështja ka të bëjë vetëm me dënimin e shqiptuar.

Më pas palët dorëzojnë të ashtuquajturën dosje të përgjigjes, ku paraqesin argumentet ligjore të tyre. Afatet se kur dorëzohet kjo dallojnë: 30 ditë për argumentet dhe burimet ligjore dhe 15 ditë vetëm për dënimin nga paraqitja e dosjes. Kjo pasohet me dosjen e kundërpërgjigjes për të cilën afatet janë më të shkurtra, 15 dhe 10 nëse ka të bëjë vetëm me dënimin.

Pas gjithë këtyre afateve, Gjykata e Apelit e cakton datën e një seance "nëse është e nevojshme", thuhet në rregullore.

Rregullorja parasheh që palët mund të dorëzojnë prova shtesë gjatë procedurës së apelit dhe nëse ato pranohen, pala tjetër mund të paraqesë kundërprova.

Gjatë vendimit, Paneli i Apelit shqyrton çdo provë shtesë të pranuar, por edhe provat që veçe janë pjesë e dokumentacionit.

Sapo të përfundojnë parashtrimet nga palët, paneli i Apelit mblidhet dhe shqyrton çështjen dhe nxjerr aktgjykim për dokumentacionin e apelit dhe për çdo provë shtesë të pranuar.

Pra, Gjykata e Apelit mund të lërë në fuqi, të zhbëjë ose të ndryshojë aktgjykimin e trupit gjykues apo të mbahet rigjykim.

Megjithatë, nëse kërkesa për apel bëhet vetëm nga personat e shpallur fajtorë, Gjykata e Apelit nuk mund të shqiptojë vendim më të rëndë se shkalla e parë.

Vendimi i apelit shqiptohet brenda 60 ditësh nga parashtrimi i fundit i palëve. Megjithatë, edhe për këtë mund të kërkohej kohë shtesë, por jo më shumë se një muaji dhe zgjatja e afatit duhet të arsyetohet.

Sipas Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar janë tri arsye për të cilat mund të dorëzohen apele për vendime të shkallës së parë: ndonjë gabim rreth ndonjë çështje juridike që e shfuqizon aktgjykimin, ndonjë gabim faktik i cili ka shkaktuar dështimin e drejtësisë ose ndonjë gabim për sa i përket dhënies së dënimit.

Nëse palët nuk janë të kënaqura me vendimin e Apelit, çështja mund të dërgohet në Gjykatën Supreme dhe më pas në atë Kushtetuese të Dhomave të Specializuara në Hagë.

Mbrojtësit e ish-presidentit, Hashim Thaçi, thanë se procesi i apelit mund të marrë vite kohë./Versus.al

1 ORE ME PARE

"Krimet kundër njerëzimit u rrëzuan", Vuçiç reagon pas vendimit të Hagës për liderët e UÇK: Nuk kemi arsye të gëzohemi ose të trishtohemi!



Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, ka reaguar pas vendimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë ndaj ish-drejtuësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në një fjalim drejtuar qytetarëve serbë, Vuçiç tha se vendimi i shkallës së parë duhet parë përmes fakteve të përcaktuara nga trupi gjykues, ndërsa theksoi se për Serbinë prioritet mbeten paqja dhe stabiliteti.

"Për Serbinë, ruajtja e paqes dhe stabilitetit është me rëndësi thelbësore. Për vendin tonë nuk ka asgjë më të rëndësishme se kaq", deklaroi Vuçiç.


Duke folur për aktgjykimin, presidenti serb tha se trupi gjykues nuk kishte konstatuar përtej dyshimit të arsyeshëm ekzistencën e sulmeve të përhapura ose sistematike ndaj popullatës civile.

Sipas Vuçiçit, kjo është një pikë e rëndësishme e vendimit, pasi, sipas interpretimit të tij, gjykata nuk e ka vënë në pikëpyetje në tërësi figurën dhe rolin e UÇK-së.

Vuçiç tha gjithashtu se disa akuza nuk janë përfshirë në aktgjykim, duke përmendur në mënyrë të veçantë akuzat për krime kundër njerëzimit, si dhe krimet e pretenduara ndaj serbëve pas 20 qershorit 1999.

Ai përmendi edhe çështjen e njohur si "Shtëpia e Verdhë", duke deklaruar se për këtë nuk është vendosur përgjegjësi në kuadër të aktgjykimit të shpallur.

"Sot, para gjykatës së të ashtuquajturës Kosovë, 4 persona u dënuan me 25, 18 dhe 13 vjet në procedurat e shkallës së parë, për një total prej 81 vjetësh. Çfarë është ajo, dhe gjërat siç i shohim ne, dhe çfarë është ajo që ne e konsiderojmë të rëndësishme, pavarësisht nëse na pëlqen diçka apo jo. Ajo që është e rëndësishme është që unë të theksoj faktet e mëposhtme: para së gjithash, trupi gjykues nuk krijoi dyshime të paarsyeshme në lidhje me ekzistencën e sulmeve të përhapura, ose sistematike, ndaj popullatës civile. Pse është e rëndësishme kjo? Kjo është e rëndësishme sepse ata nuk donin, si gjykatë e të ashtuquajturës Kosovë, të rrëzonin besueshmërinë e UÇK-së, ose të të ashtuquajturës Ushtri Çlirimtare të Kosovës.





Çfarë nuk përfshihet në vendim - krime kundër njerëzimit. Të 6 akuzat u rrëzuan. Të gjitha krimet e kryera kundër serbëve pas 20 qershorit 1999 nuk u përfshinë, sepse u konsiderua se kishte mbërritur KFOR-i dhe se nuk kishte konflikte të armatosura. Nuk ka përgjegjësi për Shtëpinë e Verdhë", tha Vuçiq.

"Nuk kemi arsye të gëzohemi ose të trishtohemi. Po e përziejmë këtë me Tribunalin e Hagës. Këtu ka një instancë tjetër. Edhe nëse vendimi konfirmohet, gjë që e kam të vështirë ta besoj, ekziston edhe një instancë e tretë - Gjykata Kushtetuese e Kosovës, e cila mund të kthehet në procedurat e shkallës së parë. Kjo është arsyeja pse nuk duhet të presim me eufori këtë vendim dhe të jemi të duruar".

"Nuk prita deri në orën 6:30 të mbërrjes për të folur pa asnjë arsye. Prita që të gjithë të lajmëroheshin."

Fjala e plotë

"Do ta filloj këtë fjalim ashtu siç do ta përfundoj: për Serbinë, ruajtja e paqes dhe stabilitetit është me rëndësi thelbësore, për vendin tonë nuk ka asgjë më të rëndësishme se paqja, dhe besoj se fakti që emocionet janë kaq të larta, edhe pas 27, dhe pas 30, dhe 35 vjetësh që nga konflikti në territorin e ish-Jugosllavisë, flet për faktin se u bë shumë padrejtësi, por edhe se nuk ishim mjaftueshëm të gatshëm të përballeshim me gabimet tona dhe krimet që u kryen në emrin tonë, por se besoj se sigurisht në të ardhmen zgjidhja qëndron në bisedë, mirëkuptim dhe dialog më të madh me të gjithë." Sigurisht, vendimi i shkallës së parë i dhënë sot para Gjykatës së Kosovës, sepse kjo është e ashtuquajtura gjykatë e Kosovës, ata krijuan atë mekanizëm të posaçëm 11 vjet më parë nën presionin e bashkësisë ndërkombëtare për të shmangur krijimin e një gjykate ad hoc, të llojit që u formua gjoja për zonën e ish-Jugosllavisë, por në fakt u formua kundër serbëve dhe popullit serb.

Sot, para gjykatës së të ashtuquajturës Kosovë, 4 persona u dënuan me 25, 18 dhe 13 vjet në procedurat e shkallës së parë, për një total prej 81 vjetësh. Çfarë është ajo, dhe gjërat siç i shohim ne, dhe çfarë është ajo që ne e konsiderojmë të rëndësishme, pavarësisht nëse na pëlqen diçka apo jo. Ajo që është e rëndësishme është që unë të theksoj faktet e mëposhtme: para së gjithash, trupi gjyqës nuk krijoi dyshime të paarsyeshme në lidhje me ekzistencën e sulmeve të përhapura, ose sistematike, ndaj popullatës civile. Pse është e rëndësishme kjo? Kjo është e rëndësishme sepse ata nuk donin, si gjykatë e të ashtuquajturës Kosovë, të rrëzonin besueshmërinë e UÇK-së, ose të të ashtuquajturës Ushtri Çlirimtare të Kosovës."

Dhe sigurisht, ata nuk hynë në thelbin e çështjes që kishte të bënte me formimin e forcave për shpëtimin e Kosovës nga Republika e Serbisë dhe Republika Federale e Jugosllavisë në atë kohë. Lidhur me vendimin e sotëm të shkallës së parë, aktakuza kishte 10 akuzat, dhe krimet kundër njerëzimit janë 6 akuzat: 1, 2, 4, 6, 8 dhe 10. Për të gjitha 6 akuzat, përkatësisht: persekutim, burgim, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje, zhdukje me forcë e personave. Pra, sipas pikës 1, sipas pikës 4, sipas pikës 8 dhe sipas pikës 10. Dua vetëm që njerëzit ta dinë se, sa i përket krimeve të luftës, 4 pika: privim i paligjshëm i lirisë ose ndalim arbitrar. Pika 5: trajtim mizor, 7: torturë. Pika 9: vrasje."

Ai është fajtor për heqje të paligjshme të lirisë për të paktën 385 persona, për trajtim mizor të të paktën 49 personave, për torturën e të paktën 303 personave dhe për vrasjen e të paktën 96 personave. Për këtë, për këtë, u përcaktua përgjegjësia penale individuale e katër të pandehurve të lartpërmendur, ekskluzivisht për krimet e luftës të lartpërmendura. Çfarë nuk mbulohet nga vendimi? Krimet kundër njerëzimit nuk mbulohen nga vendimi, siç thashë; të 6 akuzat u hodhën poshtë plotësisht, sepse gjykata, sepse gjykata vërtetoi se sulmet kishin për qëllim individët, jo popullatën e gjerë. Të gjitha krimet e kryera kundër serbëve pas 20 qershorit 1999, nuk u përfshinë, dhe mos harroni se disa prej tyre ishin më të rëndat, sepse që atëherë nuk kishte konflikte të armatosura në territorin e Kosovës dhe Metohisë.

Prandaj, nuk ka përgjegjësi për krimet më të rënda të kryera kundër serbëve në atë periudhë, Shtëpia e Verdhë, nuk është pjesë e aktakuzës për t'u marrë prova, përsëri për shkak të pamundësisë së ekspertizës së organeve të transplantuara. UÇK-ja nuk u shpall gjykatë për një organizatë kriminale në vetvetë, por për..." individëve."

Çfarë nuk përfshihet në vendim - krime kundër njerëzimit. Të 6 akuzat u rrëzuan. Të gjitha krimet e kryera kundër serbëve pas 20 qershorit 1999 nuk u përfshinë, sepse u konsiderua se kishte mbërritur KFOR-i dhe se nuk kishte konflikte të armatosura. Nuk ka përgjegjësi për Shtëpinë e Verdhë".

"Mbi familjen Shutakoviq me pesë anëtarë. Zhdukja dhe rrëmbimi i familjes Kostiq nga Priluzhi në vitin '98. Rrëmbimi dhe vrasja në afërsi të Pejës, zhdukja e civilëve serbë nga Suhareka gjatë bombardimeve në vitin '99. Zhdukja e civilëve serbë nga fshati Zhaç pranë Istogut. Rrëmbimi dhe zhdukjet në Klinë, Gjakovë, Vuçitër, vrasja e babait të Haritonit më 15 qershor '99. Vrasja mizore e Marica Miriqit para nënës së saj. Për krimin në Dojnicë, në Prizren në vitin 1999. Vrasja e fëmijëve serbë në Gorazhdëv, si dhe masakra në mars të vitit 2004, nuk u morën parasysh, dhe siç thashë, këto 6 akuzat për krimet më të rënda, krime kundër njerëzimit, nuk u shpallën fajtorë. Çfarë po e përziejmë këtë me Tribunalin e Hagës. Mendojmë se këtu ka një Këshill Apeli që do të marrë vendimin përfundimtar. Jo. Këtu ka një rast tjetër mbi Apelin..." Dhoma, kjo e ashtuquajtur Gjykatë e Kosovës ose Gjykata e Kosovës në Hagë."

"Nuk do ta besoni, është Gjykata Kushtetuese e Kosovës, do t'ju jap një shembull. Ne jemi, sigurisht, në vetë Tribunalin e Hagës, nuk do të doja të bëja një krahasim me këtë, kemi pasur tashmë vendime ku Gotovina më 24 vjet, nëse nuk gabohem, dhe pastaj ka një rishikim të atij vendimi, një rishikim të atij vendimi, dhe jo vetëm që do të reduktohet nga koha e kaluar në paraburgim, nga koha e kaluar në paraburgim, por do të jetë një lirim, kështu që nuk ka as gjurmë të faktit se ata janë kroatë që kanë kryer krime, dihet tashmë se vetëm serbët duhet të jenë përgjegjës. Kishte të njëjtin rast me zyrtarë të shumtë shqiptarë nga Kosova dhe Metohija, të njëjtin rast me Naser Orić, e kështu me radhë. Megjithatë, ka një detaj tjetër këtu që shoh që askush në publikun tonë nuk e njeh: edhe nëse vendimi konfirmohet, gjë që e gjej të vështirë, edhe nëse vendimi konfirmohet, keni një shkallë të tretë, të ashtuquajturën Gjykatë të Kosovës, e cila mund të kthehet në vendimin e shkallës së parë nëse është e përshtatshme dikush tamam." ndaj Hashim Thaçit ose ndonjërit prej atyre që janë dënuar në procedurat e shkallës së parë ose të dytë u lënduan. E drejta e tij u shkel." Lidhur me përdorimin e letres së tij, kthehuni te procedurat e shkallës së parë. Dhe tani ata kanë krijuar të gjithë vertikalen, nga gjykimi deri te dhomat e apelit brenda Gjykatës Kushtetuese, pasi është, siç thashë, gjykata e të ashtuquajturës Kosovë, dhe ata do t'i marrin vetë ato vendime. Kjo është arsyeja pse nuk duhet ta pranojmë gjithçka që ndodhi sot me ndonjë eufori ose në asnjë mënyrë, por të presim me durim dhe të kuptojmë mesazhet që mbërritën sot. Nuk e caktova rastësisht këtë fjalim për në orën 18:30; prita. Dua të shoh deklaratat e të gjithëve dhe të shoh se me çfarë problemesh po përballen Serbia sot dhe me sa hipokrizi po përballemi ne sot. Do t'ju lexoj, qytetarë të dashur të Serbisë, sepse vështirë se mund ta kuptoni gjithçka dhe çfarë po thonë njerëzit sot. Dhe pastaj ta krahasoni me diçka që ndodhi këtu 2-3 javë më parë, nuk e di kur saktësisht, me reagimet e tyre, në mënyrë që të arrihi në përfundimin se sa e vështirë është pozicioni i Republikës dhe sa të mëdha janë presionet mbi vendin tonë. Presidenti shqiptar Begaj."

"Ju patë sulmet e shqiptarëve të zemëruar ndaj EULEX-it në Prishtinë, ndaj autoriteteve holandeze në Hagë dhe nuk pati asnjë reagim të ashpër".

"Ne gjithmonë e kemi respektuar kulturën e kujtesës, por gjithashtu kemi respektuar sakrificat e të tjerëve. Ky është një mësim i madh për ne. Dhe një mësim se çfarë hipokrizie mbretëron në botë. Serbët do të jenë gjithmonë kriminelë dhe të tjerët do të jenë heronj. Serbët nuk duhet të shkruajnë, sepse sapo të ngrënë kokën, ajo kokë, metaforikisht, duhet të pritët".

"Serbët gjithmonë do t'u shtrijnë dorën të gjithëve. Nuk ka arsye për gëzim apo trishtim. Dhe sot na treguan se çfarë mendojnë ata për ne dhe viktimat tona në zonën përreth".

"Ende nuk kam marrë një përgjigje për pyetjen se pse e formuat aleancën Zagreb-Prishtinë-Tiranë. E di pse dhe për këtë arsye shqetësohem për Serbinë."

"Mesazhi ynë është paqe, qetësi, stabilitet".

"Është e qartë se në Mal të Zi po zhvillohet një fushatë mediatike kundër Serbisë dhe të gjithë aktorëve politikë u lejohet të flasin kundër Serbisë, madje është e dëshirueshme. Më vjen keq sepse e konsiderojmë Malin e Zi një shtet vëllazëror". **/Versus.al**

1 ORE ME PARE

Pas vendimit të Hagës ndaj ish-krerëve të UÇK-së, nis mbledhja e firmave nga deputetët për zhbërjen e Gjykatës Speciale





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.